



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA SHTETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. \_\_\_\_ Prot.,

Tiranë, më \_\_. \_\_ 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)

24.05.2023

Drejtuar: “AN&RA SH.P.K

Rruga: Tiranë, Njesia Nr. 9, Rruga Asim Vokshi, Godina 165, Hyrja 1, Kati 2, Apartmenti 6.

\* \* \*

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me objekt:  
Loti 2. “Blerje materiale të ndryshme për pastrim”

Numri i procedurës: REF-58637-02-10-2023 me objekt: Loti 2. “Blerje materiale të ndryshme  
për pastrim” me fond limit: 69,797,439 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë  
e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) lekë (pa TVSH) .

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike 20.02.2023, Nr. 17

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e  
mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1) “MALVINA VISOKA” SH.P.K

*Emri i plotë i shoqërisë*

L61608005C

*numri i NIPT-it*

Vlera: 39,050,920 (tridhjetë e nëntë milion e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë) lekë pa TVSH  
(me numra dhe fjalë).

2) “SINANI TRADING”&”POWER INDUSTRIES”

*Emri i plotë i shoqërisë*

J64103483H/ L51706022H

*numri i NIPT-it*

Vlera: 44,313,000 (dyzetë e katër milion e treqind e trembëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (me numra  
dhe fjalë).

3) “ALBSOLUTION” SH.P.K

*Emri i plotë i shoqërisë*

L91414015N

*numri i NIPT-it*

Vlera: 55,045,029 (pesëdhjetë e pesë milion e dyzetë e pesë mijë e njëzetë e nentë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*.

4) “AN&RA” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K12205001I**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 61,993,260 (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*.

5) “EURO MEGA” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K91624505A**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 64,006,500 (gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtë mijë e pesëqind) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*.

6) “MURATI D” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K42003004T**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 64,962,550 ( gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëqind e pesëdhjetë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*.

7)“ATLANTIK 3 +ANBIM+XHOVAN GJINI  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K22218003V/L81618008J/ L71806046M**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 66,177,280 (gjashtëdhjetëe gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*.

8) “UNIVERS PROMOTIONS” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K813224039M**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 67,234,005 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind tridhjetë e katër mijë e pesë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*.

Nga operatorët ekonomik pjesmarrës rezultojnë operator të skualifikuar si më poshtë:

1) “MALVINA VISOKA” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**L61608005C**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 39,050,920 (tridhjetë e nënëtë milion e pesëdhjetëmijë e nëntëqind e njëzetë) lekë pa TVSH *(me numra dhe fjalë)*.

2) “SINANI TRADING”&”POWER INDUSTRIES”  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**J64103483H/ L51706022H**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 44,313,000 (dyzetë e katër milion e treqind e trembëdhjetë mijë) lekë pa TVSH *(me numra dhe fjalë)*.

**3) “ALBSOLUTION” SH.P.K**  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**L91414015N**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 55,045,029 (pesëdhjetë e pesë milion e dyzetë e pesë mijë e njëzetë e nentë) lekë (pa TVSH)  
(me numra dhe fjalë).

**4)“EURO MEGA” SH.P.K**  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K91624505A**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 64,006,500 (gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtë mijë e pesëqind) lekë (pa TVSH)  
(me numra dhe fjalë).

**5)“UNIVERS PROMOTIONS” SH.P.K**  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K813224039M**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 67,234,005 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind tridhjetë e katër mijë e pesë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë).

**Arsyet e skualifikimit të OE MALVINA VISOKA” SH.P.K**

-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 e këtij operatori pasi nuk arriti të argumentojë ofetën anomalisht të ulët dhe nuk respektoi kërkesat e ligjit për dokumentimin e dhe argumentimin e ofertes si vijon:

Në shkresën e paraqitur me Lëndë ”Kthim Përgjigje” operatori ekonomik ka paraqitur vetëm një paragraf narrativ hyres dhe 3 fatura tatimore të shtijes për artikujt: 1.Qese Mbeturinash, 2. Leter Higjenike 650 g, 3. Bisht normal , Fshese me kapak, Shtup mikrofiber dhe 3.Shtup pambuku.

KVO konstaton se dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë nga elementët kushtet që përcakton ligji për këtë procedurë të cilat janë:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Referuar shkresës të operatorit ekonomik ai nuk ka arritur të argumentojë kërkesat e mësipërm qofte në mënyrë kumulative qoftë për seicilën nga këto.

1.Konkretisht për pikën a) ) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara , Operatori ka paraqitur një ofertë nga subjekte furnizues vetëm për 7 zëra nga lista e artikujve të kësaj kontrate ndërkohë që referuar shtojcës 2 të DST dhe ofertës së tij, janë gjithsej 77 zëra për

të cilët duhen të parqiten dokumente të plota mbi mënyrën e funizimit dhe pjesën ekonomike se ku do të sigurohen ato. Ky dokumentim është i domosdoshëm në kushtet kur operatori MALVINA VISOKA për një pjesë dërrmuese të artikujve ka kryer një ulje të pazakontë të cmimeve për artikuj të cilët zënë peshë të rëndësishme në vlerën dhe cilësitë /specifikimet teknike të kësaj kontrate ku përmendim : Shtupë profesionale, Shtupë pambuku, Kartë piceta buke(100 fije/pako).Letër Kuzhine e paketuar (Rul) Letër Higjenike e paketuar (min 10 rulon pako)Letër duarsh higjenike (min 100 fije/pako), Letër Alumini (min 10m), Qese Mbeturinash (të biodegradueshme, Qese Plasmasi (të biodegradueshme) etj. Për të gjithë artikujt e mësipërm dhe artikujt e tjerë mungojnë analiza ekonomike e mallrave të ofruara si dhe mungojnë të dhënat mbi funizuesit si kontratat apo faturat tatimore të shtijes që do të vërtetonin mundësinë e operatorit për ti furnizuar ato.

2.Për pikën b)zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve dhe c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi, operatori ekonomik MALVINA VISOKA nuk ka paraqitur asnjë dokument , dëshmi,vërtetim, si dhe nuk ka dokumentuar për asnjë zë origjinalitetin e artikujve të ofruar duke përfshirë të dhëna të sakta mbi origjinën, kompanitë furnzuese apo prodhuese si dhe cilësinë/specifikimet teknike sipas përshkrimit teknik “Albumi i ABP” shtojca 5 e DST. Këto mangësi janë thelbësore pasi artikujt objekt i kësaj kontrate janë furnzime për institucione të rëndësishme kryesisht disa Qendra Spitalore dhe me impakt në ushtrimin e aktiviteteve të shërbimeve ndaj pacientëve që ato mbulojnë.

3. Operatori nuk ka dokumentuar ndonjë kusht të jashtëzakonshëm favorizues që disponon për furnizimin e artikujve dhe as ndonjë element tjetër sipas kushteve në pikat ç) dhe d) Neni 93 të ligjit nr.162/2020.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të Nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, dhe arsyetimin e parashtruar më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se **operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e subjektit MALVINA VISOKA.**

***Euromega 2010 sh.p.k***

***S’kualifikohet***

Operatori ekonomik Euromega 2010 sh.p.k, nuk plotëson kushtet sipas pikës 1, germa ç) të Kërkesave të Përgjithshme për Kualifikim se “*personi(personat) që veprojnë si antar i organit administrativ, drejtori ose mbikqyrësi, oksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfasuese, vendimtarë ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë , për cdo vepër , të përcatuar në Nenin 76/1 të LPP-së*”, për këto arsye:

1. *Me vendim të formës së prerë të Gjykatës Tiranë Nr.1553 datë 02.06.2022, ish-administratori i Subjektit EUROMEGA sh.p.k Z.Hair SHAMETAJ është dënuar për veprën “prodhim të kundraligjshëm të artikujve dhe mallrave industrialë”. Megjithëse kjo figurë e veprës penale referuar legjislacionit penal është parashkruar, rezulton se për këtë çështje është shprehur me Vendim Komisioni i Prokurimit Publik, në bazë të një shqyrtimi administrativ të mëparshëm për EUROMEGA SH.P.K, në procedurën me objekt: E Hapur*

, e thjeshtuar” me Nr.REF-42473-09-20-2-2022 me objekt “Blerje detergjent dhe aromatizues për spitalin S.Dinçi”

2. Konkretisht me Vendimin Nr.116/2023 datë 15.02.2023, Komisioni i Prokurimit Publik ka interpretuar dhe ka vlerësuar se rrethanat e vendimit gjyqsor penal kundrejt administratorit të operatorit ekonomik e bëjnë operatorin ekonomik EUROMEGA sh.p.k, subjekt i skualifikimit të detyrueshëm sipas nenit 76 pika 1, germa dh), të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Referuar interpretimit të KPP sipas vendimit Nr.116/2023 , sqarohet se: për herë të parë në ndryshimet ligjore për prokurimin publik, në nenin 76 pika 1 te LPP, veprat penale të përmendura në këtë pikë parashikohen si kategori e përgjithshme jo specifike jo vepër konkrete penale, dhe sipas KPP vepra “prodhim të kundraligjshëm të artikujve dhe mallrave industrialë” është objekt i këtij neni. Gjithashtu sipas KPP “për herë të parë ky nen aplikohet dhe shtrihet jo vetëm në rastin kur është dënuar subjekti juridik por dhe anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, i operatori ekonomik,( që rastin në fjalë është dënuar ish-përfaqesuesi i subjektit EUROMEGA sh.p.k administratori Z.Hair Shametaj)
3. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara e ka referuar rastin pranë Agjencisë të Prokurimit Publik, duke kërkuar hetimin e operatorit ekonomik EUROMEGA 2010 sh.p.k për deklaram të rremë në procedurën e prokurimit, pasi ky subjekt nuk deklaroi se ish-administratori i shoqërisë ka qenë i dënuar, sipas rubrikave të detyrueshme për tu plotësuar në Formularin e Vetdeklarimit, SHTOJCA 8 e DST, në seksionin A), në procedurën e prokurimit me objekt “E Hapur , e thjeshtuar” me Nr.REF-42473-09-20-2-2022 me objekt “Blerje detergjent dhe aromatizues për spitalin S.Dinçi”

Për sa parashtruar në pikat 1-3 me sipër, KVO vendos të **refuzojë ofertën e operatorit ekonomik EUROMEGA sh.p.k**, mbështetur në Nenin 76/1 të LPP, pasi :

- Së pari,për arsye se për të njëjtën çështje ka një vendim Komisioni të Prokurimit Publik i cili është organ kompetent më i lartë se Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, dhe
- Së dyti pasi KPP dhe ASHPP kanë kërkuar hetimin dhe skualifikimin e këtij operatori ekonomik për të marrë pjesë në prokurimet publike sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi .

**BOE Sinani Trading +Power Industries sh.p.k**

**S’kualifikohet**

-Bashkimi i Operatoreve Ekonomik , nuk plotëson kushtet sipas pikës 1, Seksioni 2.3 Kapciteti Teknik mbështetur në Nenin 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publvik”, në lidhje me furnizimet e ngjashme për seicilin nga antaret e bashkimit , për këto arsye:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik , nuk plotëson kushtet në zbatim të nenit 88 pika 1 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi në Marrëveshjen e Bashkëpunimit palët nuk kanë përcaktuar pjesën e furnizimit zërat konkretë të ofertës që do të kryejë seicili nga anatarët e BOE. Deklarimi i përqindjeve e pjesëmarrjes në furnizim në masën 50% seicili në kontratën nukë përmbush kushtin e dispozitës nënligjore pasi pika 1 e Nenit 88 të VKM 285 kërkon shprehimisht ndarja e zërave të furnizimit për seicilin operator duhet të përfshihet në kontratën e BOE ku citojmë se : Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose

*furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve*

2. Referuar Marrëveshjes të Bashkëpunimit palët kanë deklaruar se kanë ndarë përqindjet e pjesëmarrjes në furnizim në masën 50% secili. Bazuar në këtë pikë të marrëveshjes dhe pikës 2 neni 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021,

- Antari i BOE Sinani Sh.p.k duhet të vërtetojë se ka kryer furnizime të ngjashme në vlerën 39% të FL/69,797,439 leke x50% = 13,610,500 lekë pa TVSH. Sinani sh.p.k per këtë pikë ka paraqitur dhe vërtetuar me fatura tatimore se ka realizuar materiale te ndryshme pastrimi +detergjente ne vleren **11,950,425 lekë Pa TVSH nga 13,610,500 lekë pa TVSH që kërkohen sipas DST.**

Sqarojmë se në lidhje me këtë kërkesë për kualifikim, KVO nuk ka llogaritur faturat si vijon:

Fature 380/2022 Dr.Pergj.Objekteve Publike =6,233,644 leke, Fature 393/2022 Dr.Pergj.Objekteve Publike = 1,282,560 leke, Fature 695/2022 Dr.Pergj.Objekteve Publike =2,923,455 leke, Fature 702/2022 Dr.Pergj.Objekteve Publike = 464,602 leke, Fature 7/2022 Dr.Pergj.Objekteve Publike , Fature 158/2021 Dr.Pergj.Objekteve Publike =4,350,460, Fature 78/2021 Dr.Pergj.Objekteve Publike =6,754,790, Fature 139/2021 Dr.Pergj.Objekteve Publike =1,784,330 (***te gjitha faturat janë veshje pune, doreza pune ndertim ,cizme ndertim, maska pune , syze pune***)

KVO arsyeton se referuar objektit të këtij prokurimi “Materiale të Ndryshme Pastrimi” pasqyruar në Shtojcën 5 Specifikimet Teknike të DST, furnizimet e realizuara sipas këtyre faturave nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit per arsye se në këtë kategori mallrash përfshihen: “*Fshesa të ndryshme, Shtupa për larje tharje dyshemeje, kaci per mbledhje mbeturinash, furca pastrami, Letër pecetë/higjenike/alumini/kuzhine, Kosha të ndryshëm mbledhje mbeturinash, Deteigjenetë të ndryshëm, Aromatizues etj. Bakala për pacientin për përdorim urinar, Pelena , Brisqe rroje,etj.....*”

- Antari tjetër i BOE Industri Power sh.p.k i takon të vërtetojë se ka kryer furnizime të ngjashme në vlerën 39% të 69,797,439 leke x50% = 13,610,500 lekë pa TVSH. Industri Poëer sh.p.k per këtë pikë nuk arriti të vëretojë furnizime të ngjashme me materiale te ndryshme pastrimi +detergjente ne vleren **13,610,500 lekë pa TVSH që i kërkohen sipas DST.**

Sqarojmë se në lidhje me këtë pikë KVO nuk ka llogaritur faturat si vijon:

Industri Power sh.p.k ka paraqit tre grupe Faturash :

- I. Fature 7/2020 e vlera 800,000 lekë ,Fature 8/2020 vlera 40,833 lekë , Fature 9/2020 vlera 40,833 lekë, Fature 10/2020 lekë , vlera 40,833 lekë, Fatura 12/2020 = 75,000 lekë, Fatura 13=41,000 lekë, fature 14=12250 lekë, fature15=4083 lekë, fature17=4083 lekë fature18=40833 lekë 19=48,748 lekë Faturat 12250 lekë, Fature= 12250 lekë Fature=26416 lekë, Fature=20416 lekë Fature=40833 lekë, Fature=488,253 lekë

Fature=14,166 lekë, Fature=14166 lekë, Fature=12250 lekë, Fature=28333 lekë Fature=25000 lekë, Fature=1583 lekë, 25833 lekë Fature=30333 lekë Fature=34583 lekë Fature=55000 lekë Fature=7083 lekë, Fature=5666 lekë Fature=1416 lekë Fature=28333 lekë Fature=4250 lekë Fature=8583 lekë Fature=25000 lekë Fature=40833 lekë Fature=20416 lekë Fature=60416 lekë Fature=4250 lekë Fature=8266 lekë Fature=14161 lekë, Fature 83/2022 =1,390,872 lekë Të gjitha faturat e mësipërme janë Maska FFP2 (materiale mjeksore per mbrojtjes personale). KVO vlerësohen se artikujt sipas ketyre faturave nuk janë artikuj të ngjashëm me objektin e prokurimit dhe nuk janë të vlefshme për qëllime kualifikimi.

- II. Ka paraqit Fature 83/2022 =1,390,872, Fature 36/2021 =3,035,580, Fature 57/2021 =1,139,400, Fature 119/2022 =2,781,350, Fature 121/2022 =600,000, Fature 36/2021 =3,035,580, Këto fatura kanë si objekt:( *perparese, jelek, xhup, brezore, helmete mbrojtese, kominoshe mushama, kepuce pune cizme te gjata, doreza saldatori, kuti ndihme te shpejte*) KVO vlerësohen se artikujt sipas ketyre faturave nuk janë artikuj të ngjashëm me objektin e prokurimit dhe nuk janë të vlefshme për qëllime kualifikimi.
- III. Ka paraqit fature 12 /2020 Bashkia Gjirokaster= 20,000 Euro me objekt “Blerje Konteniene për grumbullimin e mbeturinave”, fature 141/2020 bashkia gjirokaster= 18,700 Euro me objekt “Blerje Konteniene për mbeturinat”, fature 156/2022 Keshilli i Qarkut Berat= 99,000 Euro, “Blerje Konteniene Plastike për grumbullimin e mbeturinave”, KVO arsyeton se referuar objektit të këtij prokurimi “Materiale të Ndryshme Pastrimi” pasqyruar në Shtojcën 5 Specifikimet Teknike të DST, furnizimet e realizuara sipas këtyre faturave nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit(*Materiale pastrimi për disa spitale rajonale dhe policine e shtetit*) dhe përkufizimin e materialeve të pastrimit sipas Albumi i Agjencisë të Blerjeve të Përqëndruara, “*Specifikimet Teknike për materiale pastrimi* “ , pasi Industrie Poëer sh.p.k ka paraqit fatura me objekt “Konteniene rruge metalike dhe plastike për evadimin e mbeturinave te qyteteve Berat dhe Gjirokaster”, të cilat nuk janë të ngjashme por janë furnizime që lidhen me kontratat e shërbimeve për pastrimin e pastrimin e qyteteve. Edhe nëse do të kosiderohen si të ngjashme me artikullin kosha mbeturinash, vleresojmë se kjo kontratë përmban një gamë mjaft të gjerë materialesh pastrimi si : ku në këtë kategori mallrash përfshihen: *Fshesa të ndryshme, Shtupa për larje tharje dyshemeje, kaci per,bledhje mbeturinash, Furca pastrmi, Letër pecetë/higjenike/alumini/kuzhine, Detergjendetë të ndryshëm, Aromatizues etj. Bakala për pacientin për përdorim urinar, Pelena , Brisqe rroje,etj,* të cilat mungojnë në të gjitha faturat e paraqitura nga antari i BOE.

**Albsolution sh.p.k**

**S’kualifikohet**

-Operatori ekonomik ALBSOLUTION SH.P.K nuk plotëson kërkesat sipas Shtojcës 7 Kerkesat e Përgjithshme për Kualifikim ,pika dh), pasi gjatë shyrimit të ofertave rezultoi se ka detyrime

tatimore te pashlyera . KVO vertetoi me dokumentacion zyrtar se ALBSOLUTION sh.p.k ka shkelur detyrimet sipas Nenin 76 pika 2, germa b) të LPP, referuar shkresës Nr 15705/1, Datë 25.04.2023 (protokolluar me tonën Nr.486/3 datë 02.05.2023) nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku rezulton se *“Albsolution sh.p.k ka detyrime tatimore te papaguara në vlerën 1,879,409 lekë dhe se për këtë detyrim ka lidhur një marrëveshje për pagesë me këste Nr.9393/1 prot datë 17.03.2023”*. Në zbatim të Nenit 76/2 të LPP marrëveshja ka vlerë ligjore për qëllime kualifikimi vetëm nëse është kryer para datës të njoftimit të kontratës. Duke qenë se Marrëveshja Detyruese është lidhur mbas datës së njoftimit të kontratës (datë 13.02.2023) dhe mbas datës së hapjes të ofertave, ky operator nuk përmbush kërkesat ligjore për kualifikim dhe oferta e tij refuzohet

-Operatori ekonomik ALBSOLUTION SH.P.K nuk ka plotësuar të dhënat juridike se ka detyrime tatimore te pashlyera në Formularin e Vetdeklarimit, SHTOJCA 8 e DST, në seksionin A) ku përcaktohet detyrimi për vetdeklarimin nëse *“Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”*, duke mosparaqitur informacion kryesor për vlerësimin e ofertës. Në bazë të paragrafit të fundit të Shtojcës 7 të DST *“Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”*

-Operatori ekonomik ALBSOLUTION SH.P.K nuk plotëson kërkesat sipas pikës 3, Seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” pasi për automjetin e deklaruar me targë AA209OK , Certifikata e Sigurimit Teknik nuk është e vlefshme pasi ka afat vlefshmerie deri me 5 tetor 2021 si dhe nuk është paraqitur Sigurimi i detyrueshem i mjetit.

### ***Univers Promotions sh.p.k***

### ***S’kualifikohet***

-Operatori Ekonomik Univers Promotions SH.P.K nuk plotëson kushtet sipas pikës 1, Seksioni 2.3 Kapaciteti Teknik, në lidhje me furnizimet ngjashme, pasi furnizimet e realizuara janë me objekt(veshje të ndryshme, rroba dhe materiale pune, maska , kokore etj) , pra nuk janë të ngjashme me materiale pastrimi.

-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e VKM Nr.285 datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në lidhje me Mbështetjen e në kapacitete të operatoreve të tjerë pasi ka paraqitur një Marrëveshje Mbështetje në kapacitetet e subjektit MARI sh.p.k ku përcaktohet se ky i fundit ofron mbështetje për plotësimin e kapaciteteve për vertetimin e furnizimeve të ngjashme. Kjo Marrëveshje vjen në kundërshtim me nenin 90, pika 1,2 dhe 3 VKM Nr.285 datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi këto dispozita kanë kushtin se operatori ekonomik që do të mbështetëse ofertuesin duhet të ushtrojë një kapacitet teknik ose profesional konkret në furnizim ose shërbim. Në këtë rast mbështetja është ofruar për vertetimin e kontratave të ngjashme e cila nuk është aftesi për të cilën mund të ofrohet mbështetja por që duhet të përmbushet vetëm nga operatori ofertues.



Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1) “AN&RA” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K12205001I**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 61,993,260 (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*).

2)“MURATI D” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K42003004T**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 64,962,550 ( gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëqind e pesëdhjetë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*).

3)“ATLANTIK3 +ANBIM + XHOVAN GJINI  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K22218003V/L81618008J/L71806046M**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: 66,177,280 (gjashtëdhjetëe gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*).

Njoftimi i Vlerësimit është bërë në datë **10.05.2023**

Ankesa për dokumentat e tenderit: **JO**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

\* \* \*

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**